

LIGJ
Nr.7551, datë 22.1.1992

PËR FORCAT E NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë përbëhen nga reparte të specializuara të policisë, të cilat përdoren për ndërhyrje të shpejtë kur ka shkelje të rënda të rendit, si akte dhune, terrori, vandalizma dhe kur nuk është e mundur të mbrohet rendi nga shërbimet e tjera të policisë.

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë bëjnë pjesë në sistemin e Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 2

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë gjatë ushtrimit të detyrës zbatojnë me përpikmëri dispozitat kushtetuese, kërkesat e ligjit dhe respektojnë e mbrojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve.

KREU II
ORGANIZIMI I FORCAVE TE NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 3

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë përbëhen nga efektiva oficerë, nënoficerë dhe policë me pagesë. Organika e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Uniforma dhe shenjat e veçanta të reparteve të ndërhyrjes së shpejtë caktohen nga Këshilli i Ministrave. Ato nuk mund të përdoren nga organet e tjera.

Çdo pjesëtar i forcave të ndërhyrjes së shpejtë duhet të ketë numrin e tij personal.

Neni 5

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë në rrethe varen nga kryetari i degës së ruajtjes së rendit publik në rreth, për shërbimin e koordinimin.

Aktivizimi me shërbim i këtyre forcave për detyra konkrete bëhet me urdhër shërbimi të veçantë nga kryetari i degës së rendit në rreth me miratimin e kryetarit të komitetit ekzekutiv.

Lëvizja e forcave nga një rreth në tjetrin bëhet me urdhër të ministrit të Rendit Publik sipas kërkesës të kryetarit të komitetit ekzekutiv të rrethit përkatës.

Neni 6

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë pajisen me armë e mjete speciale për përmbushjen e detyrave që u jep ky ligj.

KREU III

DETYRAT E FORCAVE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 7

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë kanë këto detyra kryesore:

1. Ndërhyjnë forcërisht për rivendosjen e rendit kundër grupeve terroriste si dhe kur ka cënim të rëndë të rendit, të cilat çojnë në kryerjen e akteve të dhunës, të shkatërrimeve dhe të djegjeve.
2. Marrin në ruajtje deri në rivendosjen e situatës normale objekte të rëndësishme si stacione hekurudhore, trena, porte detare, aeroporte, burime energjetike e objekte të tjera të kësaj natyre, kur këto detyra nuk mund të përballohen nga forcat e caktuara për këtë qëllim dhe kërkohet ndihma e tyre,
3. Bëjnë bllokimin, kërkimin dhe kapjen e grupeve terroriste, diversioniste e keqbërëse.
4. Rivendosin gjendjen normale në kampe dhe burgje në raste rebelimi, me kërkesën e organit përkatës.
5. Marrin pjesë në likuidimin e pasojave të shkaktuara nga forcat madhore si tërmetet, përmbytjet, zjarret e ngjarje të tjera të kësaj natyre.

KREU IV

TË DREJTAT E FORCAVE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 8

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë kanë këto të drejta:

1. Të hyjnë në zyrat shtetërore, me përjashtim të objekteve që ruhen nga Garda, në ato private ose organizatave, në mjediset e tyre dhe në banesat shtetërore a private, në raste falgrante për kapjen e autorëve të veprave penale që janë në ndekje e sipër, si dhe për dhënien e ndihmës së nevojshme në raste fatkeqësish natyrore, aksidentesh dhe zjarri.
2. Të bllokojë ose të rrethojë pjesë të rrugëve, të banesave, zyra e mjedise të tjera për nevoja të domosdoshme të kryerjes së detyrës.
3. Të shoqërojnë për në organet e ruajtjes së rendit personat të cilët refuzojnë të paraqesin dokumente identifikimi, kundërshtojnë ose pengojnë forcat e ndërhyrjes së shpejtë gjatë kryerjes së detyrave, janë gjetur në vendin e ngjarjes dhe dyshohet se janë autorët e krimeve, mbajnë, përdorin dhe transportojnë lëndë eksplozive, narkotike e të tjera të kësaj natyre.
4. Të përdorin edhe armët e zjarrit për kryerjen e detyrave sipas kushteve të parashikuara nga dispozitat ligjore për përdorimin e armëve.

KREU V

PRANIMI, KUALIFIKIMI SHËRBIMI I FORCAVE TË NDËRHYRJES SË SHPEJTË

Neni 9

Pranimi i kandidatëve në forcat e ndërhyrjes së shpejtë bëhet sipas kritereve të caktuara në ligjin nr.7504, datë 30.7.1991 "Për policinë e rendit" dhe të kritereve të tjera të veçanta për përgatitjen fizike speciale Për këtë krijohet komisioni i posaçëm në bazë reparti.

Mosha për pranimin e kandidatëve në këto forca është deri në 30 vjeç.

Marrja në shërbimin e tyre bëhet me kontratë ndërmjet kandidatit dhe repartit për një periudhë prej 5 vjetësh. Pas këtij afati kontrata mund të përsëritet me dëshirën e të dy palëve.

Neni 10

Trajtimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë, për natyrën e veçantë të shërbimit, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Ndalohet përdorimi i eksitantëve në forcat e ndërhyrjes së shpejtë.

Neni 12

Ministria e Rendit Publik merr në mbrojtje punonjësit e forcave të ndërhyrjes së shpejtë ose familjet e tyre, kur u rrezikohet jeta.

Neni 13

Forcat e ndërhyrjes së shpejtë riorganizohen në bazë të këtij ligji dhe sipas kriterëve përkatëse për hyrjen në këto forca.

Shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore të deritanishme për këto forca.

Neni 14

Ngarkohet Ministria e Rendit Publik të nxjerrë rregulloren përkatëse për zbatimin e këtij ligji deri më datën 15 shkurt 1992.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.116, datë 28.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.